




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së dhjetë - X, të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën: 30.10.2020.

Prezentë në mbledhje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës ishin: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Suhat Ademi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Ilir Hasani, Mirvete Gërguri, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Albert Jasharaj, Jetmir Berisha, Ali Zogjani, Sabri Rexhepi, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mensur Grajçevci, Shaban Ademi, Hysni Hasani dhe Ljubisha Qirkoviq.

Mungon: Naser Grajçevci.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe Abdullah Prebreza - Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës pasi verifikoi kuorumin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës prezentë në mbledhje, prezantoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme me këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës: 19.08.2020 dhe 01.09.2020.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.
4. Propozim për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
6. Shqyrtimi i dytë i 'Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
7. Të ndryshme: Shqyrtimi i kërkesës për prioritet në punësim për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës. SH.A.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës së propozuar me pikën shtesë: 'Shqyrtimin e kërkesës për prioritet në punësim për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës. SH.A dhe hapi diskutimin.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, pse nuk është në rendin e ditës 'Raporti i Shtabit Emërgjent të Komunës për menaxhimin e pandemisë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës me pikën shtesë.

U votua me: njëzet vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë: ‘Shqyrtimin e kërkesës për prioritet në punësim për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës. SH.A.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës: 19.08.2020 dhe 01.09.2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Të nderuar/a anëtarë të Kuvendit të Komunës tani i kemi për aprovim ‘ekstraktet e procesverbaleve nga dy mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, të mbajtuara me datën: 19.08.2020 dhe 01.09.2020’, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, të mbajtur me datën 01.09.2020. Unë kam thënë se ne i kemi ndarë si komunë për menaxhimin e pandemisë 1.1 milion euro, prej të cilave duhet të sigurohen edhe maska për mësues dhe nxënës. Këto mjete financiare tani do të shpenzohen, sepse është anuluar ligji për pagat e zyrtarëve publik dhe ne asambleistët nëpër Komuna të Kosovës, kemi mbetur me pagë dhe kompensim për mbledhje shumë të ulëta dhe jo dinjitoze. Për mjetet financiare që janë ndarë për menaxhimin e pandemisë, furnizimin me barna, dezinfektimin e shkollave dhe për blerjen e maskave mbrojtëse, duhet të jepet llogari përmes raporteve narrative dhe financiare.

Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës i qiti në votim për aprovim ‘ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 18.08.2020 dhe 01.09.2020’ me përmirësimin e cekur me lartë të diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili në ekstraktin e procesverbalit të datës 01.09.2020.

U votua me: njëmbëdhjetë vota ‘për’, shtatë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave i aprovoi ‘ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 18.08.2020 dhe 01.09.2020’ me përmirësimin e cekur me lartë të diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili në ekstraktin e procesverbalit të datës 01.09.2020.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pyetja dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë edhe më herët e kam ngritur çështjen e ndriçimit publik, investimet e bëra duhet të mirëmbahen, po ashtu i njëjti problem është edhe në rrugën 'Fazli Grajçevci', atje janë duke lëvizur edhe qentë endacakë që paraqesin rrezik, sidomos për fëmijët. Në lagjen e Hekurudhës, te ish/Kolonia mungon rrjeti i kanalizimit, në këtë lagje është bërë një diskriminim, sa i përket investimeve publike nga komuna. Kërkesë e banorëve të lagjes Dardania është rregullimi i hyrje/daljeve në drejtim të Prishtinës, atje po krijohen kolona të gjata të automjeteve, që po paraqesin rrezik edhe për lëvizjen e qytetarëve, andaj duhet ta gjejmë një zgjidhje. Së fundi në raport me pandeminë Covid - 19, mungon raporti për menaxhimin e pandemisë, numri i të infektuarëve po rritet, madje distancë sipas rregullave, nuk ka as këtu në sallën e Kuvendit të Komunës. Për Drejtorinë e Inspektoratit e kam një pyetje, në parkun rekreativ në fshatin Sllatinë e Vogël te pishat, është një kabëll që paraqet rrezik për lëvizjen e lirë të qytetarëve, ajo gjendet në mes të pishave, ne nuk e dimë nga kush dhe për çfarë arsye është vendosur, por aty duhet të intervenohet. Po ashtu, edhe në fshatin Harilaç është duke u realizuar një investim, që mund t'i dëmton investimet tona publike atje.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me atë që e ceku anëtari i Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra, për investimet aty, pala në fjalë e ka pëlqimin e komunës dhe pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Lidhur me investimet në varrezat e fshatit Harilaç, mua më është premtuar në dëgjime publike nga Drejtori për Financa dhe Buxhet, se rrethoja e varrezave do të bëhet këtë vitë, mjetet financiare janë ndarë dhe zotuar për tender, por realizimin e këtij projekti kam informata se nuk po e lejon Kryetari i Komunës. Pyetja për investimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërtimi i sallave të sportit në fshatrat: Pomozotin dhe Harilaç, tenderi është i njëjtë, ndërsa në fshatin Harilaç, salla është për së paku njëqind metra katrorë më e vogël, unë i kam bërë matjet në dy fshatrat, arsyeja është thënë se është hapësira më e vogël, unë kërkoi që Kompanisë në fjalë t'i ndalen mjetet financiare për njëqind metra katërorë më pak në ndërtimin e sallës së sportit. Deri tani makinat zyrtare janë marrë në shtëpi nga Drejtorët e Komunës, tani Golfi 6 mirret nga zyrtarja në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, kjo veturë zyrtare parkohet kudo vend e pa vend në rrugën e 'Dardanisë' dhe përbënë një imazh të keq për komunën tonë. Tenderi për zhbllokimin dhe bartjen e automjeteve, pyes çka është ky tender për bartjen e automjeteve të qytetarëve, pse e bënë këtë komuna dhe pse çdoherë tenderin e fiton 'Dreni sh.p.k', çfarë kontrate është kjo, kontratë kornizë apo çfarë? Kjo punë është detyrë e Policisë së Kosovës, jo e komunës.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në rrugën 'Doruntina' në Fushë-Kosovë, anash rrugës po hidhen mbeturina të betonit, kërkoi që komuna në këtë rrugë të intervenon. Për Drejtorinë e Arsimit çerdhet private duhet të kenë oborre, një çerdhe po funksionon pa oborr fare. Pyes, a ka ky institucion parashkollorë privat licencë dhe pse po lejohet kjo punë jashtë rregullave minimale për operim, sidomos kur kemi të bëjmë me fëmijët?

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyetja për Drejtorinë e Arsimit, është lidhur me mos funksionimin e sallës së sportit në shkollën 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë, ku arsimtari i Edukatës Fizike ankohet se nuk mund ta zhvillon orën e mësimi dhe ushtrimet sipas

planprogramit, ne e dimë se ky është një investim i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por kërkojmë nga Drejtoria e Arsimit, që të marrë masa konkrete në këtë drejtim për rregullimin e sallës së sportit në shkollë. Pyetja tjetër është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që në rrugën kryesore 'Nënë Tereza' në Fushë-Kosovë, të bënë më shumë vendkalime, një te Çerdhja e Fëmijeve dhe një tjetër më lartë pesëqind apo shtatëqind metra, ku qarkullimi i njerëzve është më i madhë, sepse në të kundërtën do të kemi dëme të mëdha në aspektin ekonomik, sepse Ministria e Transportit kur është udhëhequr nga z. Fatmir Limaj, nuk ka ofruar zgjidhje për bizneset dhe qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, nëse ne nuk intervenojmë tani bizneset që operojnë në këtë rrugë do të zhvendosen në Komunën e Lipjanit, ku tani janë edhe Kompanitë më të mëdha shërbyese dhe tregëtare.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa pyetje për Ekzekutivin e Komunës, tani e përgëzoi punën dhe projektin në rrugën Magjistrale M9, nën lumen Sitnica që është kryerë në kohën e fundit nga komuna, por kjo punë nuk është kryerë si duhet plotësisht, projekti duhet të shkonë deri në fund, të rregullohet edhe ndriçimi publik, sepse aty kalojnë nxënësit dhe studentët e fshatit tim, meqë rregullimi i këtij nënkalimi ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës, se do ta bënë një zgjidhje adekuate për banorët e fshatit Miradi e Poshtme. Lumi Graçanka po vazhdon të helmohet prej Kompanisë 'Bylmeti', ju e dini se banorët kanë dalur në një protestë para disa ditëve, është obligim i Inspektorëve tanë të mjedisit, që të dalin në teren dhe ta eliminojnë këtë problem, që po i dëmton qytetarët për vite me radhë. Mbeturinat po hudhen në oborrin e shkollës 'Vëllëzërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme, këto punë duhet të mbikëqyren nga përgjegjësitë e komunës. Njësoi po veprohet edhe në arat tona, që ne i quajmë 'Metkovica', ka ardhur Sami Lushtaku dhe ka filluar punën aty me betonjerkë, unë pyes kush po i lejon këto punë të dëmshme për ambientin, pa asnjë konsultim me banorët e zonës, unë foli për pesë vite këtu, në atë zonë janë të vendosura gjashtë pompa të derivative të naftës, bjen zhavor me tonelata aty pa asnjë kriter, ky janë Inspektorët tanë që nuk dalin në teren. Neve si fshat në vitin 1983 na janë marrë mbi 40 hektarë toka të punueshme për zgjerimin e Hekurdhës, tani ato zona po dëmtohen, kjo punë është e dëmshme dhe e pa pranueshme për mjedisin tonë. Unë e përgëzoi Komunën apo Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientin, nuk e di cila është punëkryesi, por janë duke i rregulluar mirë argjilat në të dy anët e lumit 'Sitnica', aty është duke u bërë një punë e mrekullueshme dhe me standarde evropiane, është rregulluar një kilometër gjatësi, ne për këtë projekt publikë nuk jemi të njoftuar. Lidhur me emërtimin e rrugëve Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duhet të na siguron ortofotot për Fushë-Kosovës dhe dymbëdhjetë fshatrat tona, të nderuarë një ortofoto kushton tridhjetë euro, pastaj ne si Komision duhet të ulemi dhe të punojmë qoftë edhe një muaj pandërprerë dhe të bëjmë, emërtimin e rrugëve të reja dhe ndryshimin e disa emrave të rrugëve ekzistuese që janë emëruar pa kriterë.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Po ndërlidhem me diskutimin e parafolësitë tim z. Sabit Bullatovci, emërtimi i rrugëve është bërë me konsensus nga të gjitha partitë politike, mund të ketë patur ndonjë gabim, por pa asnjë qëllim, gabimet eventuale unë pajtohem se duhet të përmirësohen, atëherë është punuar në presion të kohës për emërtimin e rrugëve për identifikimin e sistemit të adresave dhe është thënë se asnjë ndryshim nuk mund të

bëhet para pesë viteve. Janë emërtuar disa rrugë gabim me emra kombëtarë - rrugët dytësore, që nuk ka asnjë logjikë sot, p.sh. rruga në fshatin Henc 'Bajram Curri', andaj këto rrugë duhet të ndryshohen tani, nëse kjo lejohet tani ligjërisht. Kjo pyetje është për Nënkryetarin e Komunës dhe ka të bëjë me një dukuri jo të mirë që po ndodh tani në parkun rekreativ, që tani i ka kaluar përmasat e nivelit komunal dhe duhet t'i përngjanë një parku kombëtarë. Në pjesën e fshatrave: Bardh i Madh dhe Pomozotin, ka filluar ndërtimi i objekteve dhe betonimi i zonës aty, ndërtimi shkonë andej kah fshati Vasilevë i Komunës së Drenasit, unë pyes, për këto punime, a ka leje për punë nga komuna jonë? Ajo që është për tu çuditur edhe më shumë, aty rregullohet edhe asfalti në gjatësi prej pesëdhjetë metra, të gjithë ne jemi të obliguar ta ruajmë parkun e qytetit dhe komunës tonë.

Ilir Hasani: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy pyetje, njëra është për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, a është në plan që në zonën te pishat në fshatin Sllatinë e Vogël, të ndërtohet shtegu për degën sportive të sportit të atletikës dhe triatlionit, sepse ka interesim për këtë punë nga të rinjtë e komunës tonë dhe pyetja tjetër është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit ka të bëjë me kontejnerët për familje në rrugën kryesore dhe rrugët anësore në fshatin Sllatinë e Madhe, aty kontejnerët ku hudhen mbeturinat e familjeve dhe subjekteve afariste duhet të ndahen.

Aida Alimi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Sëmundja ngjitëse dhe infektive e Covid - 19 kërkon reagim të shpejtë, ndërsa ne nuk po kemi as informata për punëtorët e infektuar në Administratën e Komunës. Unë e kam një pyetje dhe kërkesë për Drejtorinë e Inspektoratit që të intervenon shumë shpejtë, në mbylljen e kafiterisë te Stadium i qytetit, ku po zhvillohen dukuri negative dhe qyteatrët e zonës për rreth, po kanë probleme dhe shqetësime nga këto kafene, për këtë punë mund të më ndihmon edhe kolegu ynë, anëtar i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, sepse është aty për ditë, e ka lokalin e tij në atë zonë. Lidhur me emërtimin e rrugëve, dua të theksoi se emërtimi i tyre është bërë para shtatë viteve dhe është koha tani, që disa rrugë me emërtime të pa qëlluara dhe gabim të emërtohen me emra të ri, në bazë të kërkesave të qytetarëve, standardeve dhe kritereve për emërtimin e një rruge.

Migjen Kolshi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë këtë çështje e kam ngritur edhe më herët, por Drejtoria e Inspektoratit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret, mua atëherë më kanë akuzuar se unë e kam për biznesin tim, të nderuarë aty zhvillohet prostitucioni, pas orës nëntë të mbrëmjes aty kemi femra lakuriq, që shërbejnë. Banorët janë në zorë të madh me këtë kafene, aty vijnë policë dhe zyrtarët i pijnë nga dy birra dhe ikin, kjo dukuri e lejuar nuk është në rregull për banorët e zonës.

Driton Ademi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë në këtë pikë të rendit të ditës, pyetje dhe përgjigje parlamentare jam më pasivë, pasi që nuk ka kuptim të bëhen pyetje kur nuk mirren përgjigje dhe nuk zgjidhen punët e caktuara. Pyetja ime ka të bëjë me vizitën e fundit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pa agjendë në Republikën e Shqipërisë në kohën e pandemisë, pa asnjë arsye, shpenzimet e bëra për këtë vizitë, pa vendim të Kuvendit të Komunës janë të pa arsyeshme, për këtë e kërkoi një përgjigje nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës. Pyetja tjetër ka të bëjë, me Grupin Punues për hartimin e 'Rregullores për organizimin e Këshillave të fshatrave', që nuk po lejohet të punon, kërkoi që këtë çështje ta kemi temë të veçantë, e jo kjo temë të përdoret për

fushatën elektorale, me përfaqësues jo legjitim të fshatrave, përfaqësuesit e fshatrave duhet të zgjidhen në tubimet publike dhe sipas procedurave të parapara. Për këtë arsye, ne kemi peticione të tilla, siç është ky sot i banorëve të fshatit Bardh i Madh për prioritet në punësim, që nuk i plotëson as kushtet dhe kriteret bazë për një peticion të rregulltë.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për një rastë që është dashur të realizohet intervenimi shëndetësorë për një pacientë, fjala është për rrugën ‘Ramë Bogujevci’ në Fushë-Kosovë, ky personeli shëndetësorë, as nuk e ka patur idenë se ku gjindet kjo rrugë, andaj është domosdoshmëri që të bëhet emërtimi i rrugëve dhe institucionet shtetërore t’i dinë këto rrugë ku janë, të pajisen me informata dhe broshura. Pyetja tjetër është për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe ka të bëjë caktimin e Zëvendës Drejtorëshës së Shkollës në Fushë-Kosovë, para tre muajëve, është sjellur një person pa kriterë që nuk e ka as kualifikimin adekuatë universitarë dhe trajnimet profesionale për menaxhimin e shkollës. Për drejtor të shkollave procedurat e konkursit publik, duhet të shpallen tre muaj para përfundimit të kontratës, sipas Ligjit për Arsimin Para-Universitarë.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani do të jap përgjigje për punët që i di, të tjerat për të cilat nuk kemi përgjigje tani, do t’i bartim në Drejtoritë përkatëse të komunës. Lidhur me ndriçimin publik në rrugën ‘Fazli Grajçevci’, ai do të rregullohet, ndodh që herë pas herë edhe nëpër fshatra nuk funksionon ndriçimi publik, pastaj puna e qenëve endacakë është një problem me vite për komuna, kjo punë është tentuar të bartet në komuna, ka patur diskutime të shumta dhe është vendosur që me këtë çështje të mirret niveli qendrorë dhe regjional, sepse kotë punohet në një komunë, kur nuk punohet në gjithë regjionin përkatës, sepse qentë endacakë lëvizin dhe problem nuk zgjidhet. Rregullimi i hyrje/daljeve nga rruga ‘Dardania’, në drejtim të Prishtinës, ne mendojmë se do ta zgjidhim me ‘Planin e mobilitetit’, i cili është në proces dhe mund të zgjatë pakë në një apo dy vite, është menduar dhe kemi qenë në bisedime që kjo punë të rregullohet me një rrugë alternative, që do ta shkarkonte qytetin tonë mbi lumin ‘Prishtina’, andej për rreth Hekurdhës, por ndodhi pandemia Covid - 19 dhe punët kanë ngecur. Lidhur me të infektuarit me Covid - 19, ata që dalin pozitiv nuk vijnë në punë, tani është pozitiv Drejtori për Arsim, pastaj Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe z. Afrim Krasniqi, kur dalin negativ në testimet që bëhen nga Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik kthehen në punë, puna me palë e keni parë se është reduktuar. Kërkesa për asfaltim të parku rekreativ është kërkuar nga banorët e fshatit Bardh i Madh, për kabllon atje ne do të verifikojmë këtë punë dhe do të veprojmë. Për ndërtimet Inspektorët do të incizojnë gjendjen në teren, do t’i lëshojnë procesverbalet për ndërprerjen e punimeve, nëse janë pa leje do të ndërpriten punimet atje. Pyetjeve të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci nuk do t’i përgjigjem tani, sepse punimet janë në proces, ato pyetje evidentohen dhe duhet të marrin përgjigje nga Drejtoritë e Komunës. Për çështjen e ngritur nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi për projektin për ndërtimin e sallës së sportit, për njëqindë metra më pakë më pakë, kjo punë do të shikohet dhe pagesa do të realizohet sipas punës së kryerë, këtë punë do ta verifikojmë saktë. Lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare, edhe kjo punë do të verifikohet dhe Kryetari i Komunës dhe do të mirren masa adekuate, për rrethojnë e varrezave duhet ta verifikojmë ky projekt publik, a është nga granti qeveritarë apo

nga të hyrat vetjake. Çerdhet private licencohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për rrugën 'Doruntina' problemën do ta adresojmë te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe mbeturinat nga aty do të largohen. Për sallën e sportit në shkollën 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë, nëse Kompania ndërtimore nuk i kryen këto punë të mbetura, ne duhet ta zgjidhim këtë problem, siç e kemi zgjidhur edhe problemin e funksionalizimit të shkollës në fjalë, por duhet ta kemi një kodë buxhetorë për këtë punë, që merrë kohë për vendosjen e tij në buxhet sipas procedurave.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Me 'Hartën Zonale të Komunës' që e kemi përfunduar dhe po zbatohet nga data një shtator dhe tani 'Planin e Mobilitetit' që është në hartim e sipër, do ta zgjidhim çështjen e shtegut për çiklistë në qytetin e Fushë-Kosovës. Shkurt atë që e potencoi anëtari i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci, për betonjerkën në fshatin Miradi e Epërme, kjo është një problem gjygjësorë, nuk është në kompetencën tonë, ta dini se Inspektorët tanë kanë qënë atje, por ne dhe Ministria e Infrastrukturës kemi kompetenca të barabarta, kjo betonjerkë nuk ka leje të punës, si dhe nuk e kemi shqyrtuar në bazë të hartës zonale. Inspektorët e Shërbimeve Publike dhe zyrtarët e Drejtorisë së Planifikimit Urban, kanë dalur në teren dhe kemi urdhër edhe nga Kryetari i Komunës, që të mos lëshojmë asnjë leje për ndërtim të objekteve përgjatë parkut rekreativ në fshatin: Pomozotin dhe Bardh i Madh, kjo zonë do ta ketë një trajtim të veq-antë. Rruga në fshatin Lismir do të rregullohet, jemi të informuar për dëmtimin që e theksoi anëtari i Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili.

Shaban Ademi: Arsyeja pse unë po e ngriti këtë punë është, se ju i nderuari Drejtor për Planifikim Urban nuk jepni leje për ndërtim, por objektet atje po ndërtohen dhe në fund ato do të legalizohen dhe trajtohen sipas 'Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje', që i favorizon këta ndërtues pa leje, gjendja faktike e tyre më vonë pranohet nga komuna, sepse Inspektorati në komunë nuk funksionon. Për udhëtimin zyrtarë në Bashkinë e Lezhës, ju e dini që unë edhe në mandatin e kaluar nuk kam shkuar asnjëherë, më herët para dy mandateve shtatë vite me parë po disa herë, madje edhe vetë i kam siguruar ftesat njëherë nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë dhe njëherë tjetër nga Bashkia e Kavajës. Këtë herë kam shkuar në pajtim edhe me kolegun z. Sabri Rexhepi dhe jemi kthyerë ditën e dytë, por pritja në Bashkinë e Lezhës nga udhëheqja e bashkisë atje, ka qënë vëllazërore dhe i'a ka vlejtur ky udhëtim zyrtarë.

Driton Ademi: Pa ndonjë temë të veçantë vizita në kohën e pandemisë nuk arsyetohet, nuk ka arsyeshmëri për shpenzimet e bëra, pa miratim paraprakë nga Kuvendi i Komunës.

Drejtori për Planifikim Urban: Zyrtarët tonë i kanë vendos shiritat në objektet pa leje të ndërtimit, por ata janë larguar nga ndërtuesit, atje janë duke u ndërtuar disa shtëpi të vogla, por ne nuk do t'i pajisim me leje të ndërtimit. Ju duhet ta dini se disa ndërtues po e shfrytëzojnë të shtunën dhe të dielen, si dhe po i betonojnë objektet e tyre, kështu po e vendosin në pozitë të vështirë komunës, sepse çdo intervenim duhet paraprakishtë të lajmërohet në polici. Ndërtimet pa leje që mund të legalizohen sipas 'Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje', janë vetëm objektet e ndërtuara deri në vitin 2018. Për sallën e sportit në fshatin Harilaç, që u ngritë si shqetësim nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, aty mbikëqyrës janë zyrtarët nga Drejtoria e

Planifikimit Urban dhe sipas vizatimeve, aty gjithë çka është në rregull, ju mund ta shikoni dokumentacionin e tenderit.

Pika e tretë (3) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Raportin i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020’, i cili përfshinë punën, aktivitetet dhe projektet e parapara për realizim, duke e marrë në konsiderim faktin se institucionet komunale kanë vepruar në kohën e pandemisë Covid - 19. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, është mirë që ta respektojmë së paku distancimin social, ta kemi një pushim pesëmbëdhjetë minuta për ajërosjen e sallës së Kuvendit të Komunës, sepse edhe në mesin tonë kemi persona të dyshuar për infektim, por nuk dua të hy këtu me emra, secili që ka indikacione për infektim duhet të jetë në nivel të përgjegjësisë individuale për t’i mbrojtur njerëzit. Lidhur me ‘Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2020’, aty prezantohet me të dhëna puna statistikore, aktivitetet dhe projektet publike, varësisht nga kompetencat e secilës Drejtori të Komunës, materiali është shumë voluminoz dhe më shumë paraqet punën e drejtorive, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e kemi shqyrtuar dhe analizuar punën e secilës drejtori dhe punën e realizuar e vlerësojmë si punë pozitive, duke marrë parasysh edhe rrethanat në të cilat kemi vepruar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

Ali Ismaili: Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, unë tani do të diskutoi shumë shkurt, ‘Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës’, nuk votohet, por ne duhet të debatojmë për të paraqitur edhe anën e mirë të punës së realizuar, por asnjëherë në raport nga drejtoritë e Komunës nuk paraqiten sfidat e tyre, andaj ne kemi shumë pak mundësi që të japim sugjerimet tona, për përmirësime në të ardhmen. Sot është ditë e Xhuma dhe i kemi për shqyrtim dy pika shumë të rëndësishme: ‘raportin e punës dhe raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020’, andaj kërkoi nga ju znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, që mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mos lihen në këtë ditë, shumë herë më keni respektuar në të kaluarën, ndoshta kjo ndonjëherë varet edhe nga rrethana tjera, por atëherë kur keni mundësi ta keni parasysh këtë fakt. Unë po e shfrytëzoi mundësinë tani t’i them disa fjalë për ‘raportin e shpenzimeve’, unë e takova Drejtorin e shkollës ‘Mihal Grameno’ z. Ismet Gashi dhe i thashë i nderuarë, se i keni shpenzuar 1,700.00€ për karburante dhe 500.00€ për mirëmbajtjen e makinës vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, ai mu përgjigj se nuk ka makinë zyrtare, andaj unë po them tani se shpërndarja e shpenzimeve në këtë mënyrë nëpër kodet buxhetore, është një praktikë e keqe. Për paga dhe meditet Zyra e Kryetarit të Komunës ka shpenzime gati sa e gjithë, Drejtoria e Administratës me numërin më të madh të punëtorëve në komunë.

Aida Alimi: Lidhur me ‘Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020’, nuk kam nevojë as të diskutoi për detajet e tij, sepse Kryetari i Komunës nuk e respekton punën e Kuvendit të Komunës, as kur shqyrtohet dhe analizohet raporti i tij i punës njëherë në gjashtë muaj. Ndërsa kur shikohet shpenzimet e raportit financiar për gjashtëmujorin e

parë të vitit 2020, në Komunën e Fushë-Kosovës nuk vërehet fare se këtu ka patur pandemi, këtë fakt e kam cekur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj mund të konstatojmë se komuna jonë është fenomen, me individë të caktuar që kanë punuar në mënyrë të rregulltë edhe në kohën e pandemisë, sa i përket shpenzimeve.

Migjen Kolshi: Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës, debatohet dy herë në vitë dhe kur Kryetari i Komunës nuk e sheh të arsyeshme të vjen në mbledhje, as kur debatohet për raportin e tij, me gjithë respektin për Nënkryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që janë prezentë qdoherë, nuk ja vlenë as të lëshohemi në diskutime për përmbajtjen e tij.

Durim Hajra: Lidhur me 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020', nuk ja vlenë as të diskutojmë, unë mendoj se për përmbajtjen e tij nuk është i njoftuar as vetë Kryetari i Komunës, andaj unë do të kaloj në diskutimin për raportin e shpenzimeve, nëse na lejoni znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, me pajtimin edhe të anëtarëve tjerë të Kuvendit të Komunës që diskutimet për pikën tre dhe katër të bashkohen. Pa e zgjeruar në diskutimin tim shpenzimet e kryera janë enorme ky 46,540.00€ janë shpenzuar për dreka zyrtare, të nderuarë kolegë të pozitës, për ushqim dhe pije janë shpenzuar gjithsej 73,000.00€, në vend që këto mjete financiare të ishin shpenzuar për furnizime mjekësore për luftimin e pandemisë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Kjo që po e thuani ju z. Durim Hajra është e saktë, janë shpenzuar 188,000.00€, por në këtë shumë hyn mallërat dhe shërbimet, mjetet nga rastet emergjente, në këtë mënyrë e kemi menaxhuar pandeminë deri këtu, pa i prishur projektet kapitale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Me pajtimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, diskutimi për pikën tre dhe katër të rendit të ditës, ne do t'i bëjmë bashkë, ndërsa në fund të diskutimeve votohet për:

Pikën e katërt (4) - Propozimin për aprovimin e raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

Durim Hajra: Për shtypje jo marketing, shpenzime për anëtarësimë në kohën e pandemisë dhe mirëmbajtje janë shpenzuar 18,000.00€, për qiranë e pajisjeve janë shpenzuar 176,000.00€, vetëm në Zyrën e Kryetarit të Komunës janë 600.00€, për dreka zyrtare janë shpenzuar 1,079.00€, pastaj kemi shpenzime për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, po thuaj se në secilën Drejtori të Komunës. Për dreka zyrtare janë shpenzuar 1,079.00€, në Zyrën e Kuvendit të Komunës janë shpenzuar 889.00€, unë po flas vetëm këtë që po e shoh në raportin financiar. Nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për 'Koloninë e arteve' janë shpenzuar 5,224.00€ dhe për subvencione tjera janë shpenzuar 3,750.00€. në Infrastrukturën Publike janë shpenzuar 4,000.00€ për dreka zyrtare, ndërsa për ushqim dhe pije janë shpenzuar 8,944.00€. në administratën e arsimit derivate të naftës për ngrohjen qendrore janë shpenzuar 8,191.00€, në këtë formë nëpër shkolla dhe çerdhen 'Gëzimi Ynë' janë shpenzuar 85,000.00€, për shpenzime të gjykatave janë shpenzuar mjete financiare në shkollën 'Mihal Grameno', 'Zenel Salihu' dhe 'Lismiri', janë shpenzuar mjete financiare edhe në shkolla që nuk kanë vetura zyrtare.

Nënkryetari i Komunës: Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, përmbanë të dhëna për punën e kryerë nga secila Drejtori e Komunës. Shpenzimet që u përmenden nga opozita tani për dreka zyrtare janë një inkuadrim në fushatë për zgjedhje, ne nuk i

mohojmë shpenzimet, sepse ato janë të dhëna në shifra nëpër secilën Drejtori të Komunës. Komuna e Fushë-Kosovës ka punuar me kapacitetin esencial të domosdoshëm në secilën drejtori dhe punët publike nuk kanë ngecur, të gjithë personat kyqë kanë punuar edhe në tre muajt më kritikë në pranëverën e këtij viti.

Driton Ademi: I nderuari z. Nënkyetar i Komunës, lëri drejtorët të zhvillohen, mos u përgjigjë për punët e tyre. Raporti i punës është narrativ dhe përshkrues, andaj dallon me raportin financiar për buxhetin e shpenzuar, nga këto raporte, auditori i nxjerrë shumë lehtë keqë-përdorimet dhe keqë-klasifikimet. Unë nuk kërkoj asgjë më shumë vetëm se raporti i punës dhe raporti financiar janë dokumente zyrtare, ato të publikohen në ueb-faqën e komunës.

Sabit Bullatovci: Është e vërtetë sot jemi në shekullin XXI, me komunën tonë ka qeverisur për njëzet vite Lidhja Demokratike e Kosovës, unë kam qenë i pari Drejtor për Gjeodezi në vitin 1999, ne sot i kemi njëmbëdhjetë drejtor të komunës, prezentë janë vetëm tre drejtor të komunës, të nderuarë unë sot nuk po flas vetëm për këtë mbledhje, kjo nuk është fare në rregull, raport i punës është i drejtorëve, ata duhet ta mbrojnë punën e tyre. Ne kemi qeverisur me 34.000 mijë banorë sipas regjistrimit zyrtar të vitit 2011, por në fakt shërbimet komunale ofrohen për rreth 50.000 mijë banorë, këto shërbime ofrohen nga secila drejtori me buxhet të limituar krahasuar me popullsinë që jeton dhe vepron në komunën tonë. Drejtorja e Administratës e ka raportin nga faqja 5-10, ka vetëm përsëritje, ndërsa Drejtori i Financave dhe Buxhetit është po thuaj se çdo herë prezentë, ne jemi këtu që të mos keqpërdoren 12 milion euro buxhet, prej tyre 4.5 milion euro janë për projekte publike investive, secili drejtor duhet ta mbrojnë punën e tij, mua më dhembë shpirti për mënyrën e përdorimit të makinave zyrtare, unë jam inxhinierë i diplomuar dhe kurrë nuk kam hipur në makinë zyrtare për ndonjë punë, e kemi shumica nivelin e lartë të kualifikimit, kemi buxhet real dhe të mjaftueshëm për realizimin e punëve të mira, vetëm asfaltë po bëhet, puna e komunës duhet të jetë kreative në bashkëpunim me qytetarët. Unë në vitin 1996 e kam rregulluar vetë rrjetin e kanalizimit me vetëkontributin e banorëve, sot nuk shihet asnjë iniciativë e të rinjëve. Në orën katër asnjë punëtorë nuk është në ndërtesën e komunës. Shkollat tona kanë problem substanciale, 85% e nxënësve janë me sukses të shkelqyeshëm, ku është faji për këtë punë, pastaj rrugët janë emërtuar para disa viteve me shumë gabime, tani nuk sigurohen ortofotot nga Drejtorja e Gjeodezisë. Duhet të përmirësohet performanca e punës nga komuna, unë sot jam në moshën 70 vjeçare dhe e mirëmbajë vetë parkun në fshatin tim, kanë qenë 120 metra kub të dheut aty, vetë e kam rrafshuar, për të mirën e fëmijëve tanë.

Migjen Kolshi: Kryetari i Komunës raporton dy herë në vitë, edhe atëherë nuk vjen, andaj për raportin e punës nuk i'a vlenë as të diskutojmë, sepse raporti as nuk votohet. Lidhur me raportin financiarë të shpenzimeve unë jam për shtatë vitë në Asamblenë Komunale, këtë vitë përveç shkollën 'Mihal Grameno', ka shpenzime për dreka zyrtare edhe në shkollën 'Bajram Curri', 5,000.00€. Nga shpenzimet e realizuara nuk vërehet se në Komunën e Fushë-Kosovës ka patur pandemi.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Lidhur me shpenzimet për shumën prej: 404,000.00€, unë i kam sqaruar shumë qartë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, mjetet financiare i kemi marrë nga kategoria ekonomike e projekteve kapitale

prej dy kodeve: kodit të bashkëfinancimit dhe kodit të rasteve emërgjente dhe nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve, për të mos i prishur projektet tjera kapitale në interesin e përgjithshëm të qytetarëve. E kam sqaruar se mjetet financiare për shpenzim janë marrë nëpër departamente të ndryshme, promutacioni nëpër kode ekonomike të shpenzimeve vjen edhe për arsye që i kam sqaruar edhe në të kaluarën, ne ofrojmë shërbime komunale në arsim dhe shëndetësi për 50.000 mijë banorë, për neve e rëndësishme është se secili shpenzim bëhet në bazë të rregullave financiare që parashihen si: ligjit për menaxhimin e financave publike dhe nëntëmbëdhjetë standardeve të kontabilitetit, nuk kemi asnjë vërejtje nga auditimi i jashtëm, pasqyrat financiare përputhen dhe janë conform rregullave financiare. Mjetet financiare të grumbulluara në muajin nëntor dhe dhjetor nuk mund të shpenzohen, i kemi zotime për shpenzim 2 milion euro, në proces janë edhe 3 milion euro mjete të lira.

Driton Ademi: Unë nuk po ju kuptoi drejtë juve, ne si Kuvend i Komunës e miratojmë buxhetin e komunës, planifikimi i buxhetit është një vjeçarë për të gjitha kategoritë ekonomike, ndërsa qeverisja e juaj bënë promutacion lëvizje të mjeteve financiare nëpër kategori ekonomike, kjo është shkelje e ligjit, edhe opinion i modifikuar i auditimit, nuk do të thotë se gjithë çka është në rregull. Ju duhet ta keni parasysh parimin e saktësisë në ekzekutimin e buxhetit, unë nuk po them asgjë tjetër këtu, por vetëm publikoni raportin financiar për shpenzimin e buxhetit në ueb-faqën e komunës, sepse këtë e kërkojnë edhe normat juridike dhe rregullat për transparencën e shpenzimeve.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 4,403,041.39€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,682,048.39€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,959,891.93€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 746,180.27€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 14,920.80€.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej 15 minuta.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozim për miratimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021’, ftoi Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik që të na jap sqarime.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sikur edhe në vitet e kaluara kërkohet që të miratohen nornat tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin e ardhshëm 2021, pa ndryshime, normat tatimore janë të njëjta me vitin 2020.

Driton Ademi: Kjo punë është e rregulluar me ligj, por ne duhet ta kemi një tabelë skematike, se si caktohen normat tatimore prej 0.15, cila është lëvizja nga 0. Unë pyes cili është kriteri për caktimin e normës tatimore? Duke patur parasysh aspektin social dhe këtë vit të pandemisë, operimin e bizneseve, për vitin e ardhshëm ka kohë që këto norma tatimore të analizohen dhe ndryshohen.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për miratimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021’ U votua me: dymbëdhjetë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe dy abstenime, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për miratimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021’ dhe mori:

V E N D I M

‘Për miratimin e ‘Propozimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021’.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i ‘Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e dytë, ‘Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë’. Ky ndryshim lidhet me emërtimin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare, në Qendër të Mjekësisë Familjare në pjesën më të dendur të qytetit tonë, për arsye të migrimit të popullsisë nga komunat tjera, synimi është që shërbimet shëndetësore të jenë më afër për qytetarët.

Remzi Shala: Ky ndryshim ka të bëjë vetëm me emërtimin e objektit shëndetësorë, që e sqaroi Kryesuesja e Kuvendit të Komunës. Synimi është të funksionalizohet objekti i ri shëndetësorë i ndërtuar në rrugën ‘28 Nëntori’.

Migjen Kolshi: Unë pajtohem që Ambulanca e Mjekësisë Familjare atje, të shndërrohet në Qendër të Mjekësisë Familjare, sepse më shumë shërbime shëndetësore do të ofrohen për qytetarët. Por ne e kemi një problem tjetër shumë serioz, lëshimin e punës nga mjekët në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-kosovë, nga konkursi i fundit në nivelin qendror për mjekë. Mjekët në Qendrën tonë shëndetësorë të projektit të Karitasit e kanë patur pagën vetëm 360.00€, kjo është fyerje për punën e mjekut dhe personalitetin e tij, ndërsa menaxhmenti, në vend se të punëson ndonjë mjekë nga komuna jonë, ka punësuar një mjekë nga

Komuna e Skënderajit, që është transferuar këtu i moshës gjashtëdhjetë vjeçare, pasojat e këtyre veprimeve dhe vendimeve të pa logjikshme do t'i bartë popullsia e komunës. Pyes sa është numri i mjekëve që do ta lëshojnë punën në fund të këtij viti?

Nënkryetari i Komunës: Ne këtu kemi të bëjmë vetëm me plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, për funksionalizimin e objektit të ri shëndetësorë. Punëtorët shëndetësorë të Karitasit, i kanë patur pagat e ulëta, aty është mjeku i ri Fatbardhi, vajza e Afrimit, unë jam që të përkrahen mjekët dhe kuadrat e komunës dhe të ri në moshë.

Remzi Shala: Momenti është i disfavorshëm për komunën tonë, disa mjekë do të shkojnë në specializim, disa janë punësuar në konkursin e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë, neve do të na ikin 19 mjekë dhe infermieri deri në fillim të vitit 2021 dhe do të kemi shumë vështirësi në funksionim. Politika e punësimit nuk ka qenë e duhura, unë vetë kur kam shkuar në Komunën e Drenasit në një konkurs pas diplomimit, më kanë thënë se jeni i teti me radhë. Mjeku është gjynah me pritë, kjo me mjekun e punësuar nga Komuna e Skënderajit, nuk është në rregull.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për miratim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e miraton:

'Për ndryshim-plotësimin e nenit 3, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017 lidhur me emërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare Nr. 5 në rrugën '28 Nëntori' në Fushë-Kosovë dhe vendosjen e saj në organogramin e institucioneve të kujdesit parësorë shëndetësorë'.

Pika e shtatë (7) - Të ndryshme: Shqyrtimi i kërkesës për prioritet në punësim për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës. SH.A.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Kërkesën për prioritet në punësim për qytetart e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës SH.A'. Tani bashkëngjitur në material e keni edhe kërkesën e parashtruar nga banorët e fshatit Graboc i Poshtëm, për prioritet në punësim. Ftoi Nënkryetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Nënkryetari i Komunës: Për shqyrtim në Kuvendin e Komunës ka ardhur kërkesa e banorëve të fshatit Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe Lismir për prioritet në punësim të 30-40% në Korporatën Energjetike të Kosovës SH.A. në kushte të barabarta, sepse këto fshatra janë shumë të dëmtuara nga veprimtaria ekonomike e mihjes sipërfaqësore të Bardh i Madh dhe Korporata energjetike. Nëse qytetarëve të Komunës tonë dhe komunës fqinje të Obiliqit nuk u jepet prioritet në punësim, kësaj radhe menaxhmenti i korporatës energjetike e kanë thënë edhe në takime në Qeverinë e Kosovës, do të ballafaqohet edhe me protestat e banorëve tonë, sepse ne nuk mund të punësohemi në vende tjera jashtë komunës tonë p.sh në konkurset e Kombinatit të Trepçës. Ne nuk po kërkojmë vende profesionale në menaxhmentë, por punëtorë teknik të makinerisë e vende tjera të punës. Rinia e këtyre fshatrave duhet të ketë prioritet në punësim.

Sabit Bullatovci: Kërkesa e banorëve të fshatit Bardh i Madh e ka arsyeshmërinë e saj, por ne nuk kemi reaguar për njëzet vite lidhur me këtë fenomen negativë, për punësimet në Kompaninë 'Trainkos', aty kanë ardhur njerëz nga Peja, Gjakova, Pudujeva e Mitrovica, nuk janë pranuar njerëzit tanë as për shërbime, në vendin e punës pastrues. Neve për rregullimin e Hekurudhës na janë marrë 40 hektarë tokë. E vetmja Kompani që ka punësuar të rinjtë, djem dhe vajza nga fshatrat tona është Kompania 'Nora Market', sepse dhëndri i saj është nga fshati jonë. E kemi lutur z. Bedri Prishtina për ta punësuar një kimiste tonën por nuk ka pranuar. Këto iniciativa është dashur të mirren në vazhdimësi në njëzet vitet e fundit. Edhe Fushë-Kosova dëmtohet ndoshta edhe më shumë nga Korporata Energjetike e Kosovës, por vetëm komuna fqinje e Obliqit e përfiton grantin qeveritarë prej 5 milion eurove, njerëzit tanë nuk kanë punuar për këtë proces. Kemi mungesë të njerëzve tonë në vende ku vendoset për zhvillim dhe punësim.

Driton Ademi: Unë jam përkrahës i peticioneve, petitionin duhet ta nënshkruajnë 50% e banorëve, ky mekanizëm duhet të përdoret në mënyrë profesionale. Puna e punësimit nuk është në kompetencën tonë, unë nuk besoj se ky peticion i yni nuk do të ketë efektin e tij.

Jetmir Berisha: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Kjo kërkesë, mendoi se është e qëlluar për të kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Korporata Energjetike e Kosovës SH.A, punësimin me prioritet të rinisë së fshatrave: Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh dhe fshatrat tjera, fshati ynë është shumë i dëmtuar nga veprimtaria ekonomike e korporatës, kemi mungesë të ujit, qarje të shtëpive të banimit. Në dhjetë vitet e fundit nuk është punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës asnjë banorë i fshatit Graboc i Poshtëm. Banorët tonë për kundër dëmeve të shkakta si: zhurmës, pluhurit, mungesës së ujit e tjera, nuk kanë gëzuar asnjë privilegj në punësim, do të duhet të ishte e kundërta, andaj ne kërkojmë nga Ekzekutivi i Komunës që të jetë më aktiv në parashtrimin e kërkesave tona për punësim. Punësimi i të rinjëve në Korporatën energjetike, do të kthente sado pakë dinjitetin e humbur dhe shpresën për rininë tonë, ose ata do ta marrin rrugën e migrimit.

Migjen Kolshi: Kërkesa e banorëve të fshatit Bardh i Madh për prioritet në punësim meriton të përkrahet nga Kuvendi i Komunës, por deri tani praktika ka treguar se në Kompanitë publike të hekurudhës, Aeroportit dhe të tjera punësimi është bërë 50-50% nga partitë në pushtet. Ne shpresojmë që kjo kërkesë e Komunës tonë, do të trajtohet drejtë dhe seriozisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.

Aida Alimi: Nuk dua të përsëris fjalët e kolegëve të mi, por kjo kërkesë e banorëve të Komunës së Fushë-Kosovës, duhet të përkrahet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.

Mirvete Gërguri: Ne si fshat Bardh i Madh jemi të dëmtuar nga veprimtaria ekonomike e Korporata Energjetike e Kosovës SH.A, por caktimi i prioritetëve në punësim varet nga pushteti i nivelit qendror. Ne jemi që të përkrahen njerëzit që e kanë kualifikimin profesional si: juristë, ekonomistë, inxhinierë dhe punëtorët tjerë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Kërkesën për prioritet në punësim për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës SH.A', të parashtruar nga banorët e fshatrave: Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.


Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovon:

‘Kërkesën për caktimin e prioritetit në punësim për banorët e fshatrave: Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës SH.A’, e cila i drejtohet menaxhmentit të Ministrinë e Ekonomisë e Ambientit dhe Korporatës Energjetike të Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 13:00h.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Për Vjollca Konjusha

